



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Ligji Nr.02/L-8**

**PËR VERËRAT**

Kuvendi i Kosovës

Duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/9 të dt. 15 maj 2001 për Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, Kreu 9.1.26 (a) dhe 5.1. (j)

Më qëllim të rregullimit të prodhimit dhe qarkullimit të rrushit për prodhimin e verës, prodhimit dhe qarkullimit të verës dhe produkteve të tjera nga përpunimi i rrushit dhe verës:

Miraton:

**LIGJIN PËR VERËRAT**

**KAPITULLI I**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Me këtë ligj rregullohet prodhimi dhe qarkullimi i rrushit për prodhimin e verës, prodhimi dhe kushtet e vënies në qarkullim të verës dhe produkteve të tjera të përpunimit të rrushit dhe verës, mbrojtja e verës së prodhuar në rajonin e caktuar gjeografik i cili dallohet me kushtet e veçanta klimatike, tokësore dhe kushteve tjera.

**Përkufizimet**

**Neni 2**

Termat që përdoren në këtë ligj kanë domethënjën si vijon:

- 1) **Vera:** prodhimi i fituar ekskluzivisht nga fermentimi alkoolik i tërësishëm apo i pjesërishtëm i rrushit të freskët, të bluar, të pabluar apo mushtit të rrushit.
- 2) **Vera Kosovare:** vera e prodhuar në Kosovë që ekskluzivisht rrjedhë nga varietetet e hardhive të klasifikuara për prodhim të verës. Fortësia minimale natyrore alkoolike është 7,5 % vol. ndërsa fortësia aktuale alkoolike nuk është më e vogël se 8,5 % vol. Përmbajtja e përgjithshme e aciditetit e shprehur si acid tartarik nuk është më e vogël se 3,5 gram/litër ose 46,6 mill ekuivalenta /litër.

3) **Rrushi i freskët:** fruti i hardhisë që përdoret për të prodhuar verën, teknologjikisht i pjekur dhe pak i terur, që mund të bluhet apo shtypet me pajisje normale në bodrume të verës dhe të cilat në mënyrë spontane mund të prodhojnë fermentim alkoolik.

4) **Mushti i rrushit:** prodhim i lëngët i fituar në mënyrë natyrore apo me procese fizike nga rrushi i freskët. Fortësia aktuale alkoolike në njësi vëllimore nuk duhet të jetë më shumë se 1%.

5) **Mushti i rrushit në fermentim:** prodhimi i fituar nga fermentimi i mushtit të rrushit dhe me fortësi aktuale alkoolike në njësi vëllimore jo më shumë se 1% mirëpo jo më pak se tri të pestat e fortësisë së përgjithshme alkoolike.

6) **Mushti i koncentruar i rrushit:** mushti i rrushit i pakaramelizuar që fitohet nga dehidrimi i pjesërishëm i mushtit të rrushit me një metodë të autorizuar e ndryshme nga ngrohja e drejtpërdrejtë në atë mënyrë që vlera e paraqitur në refraktometër në temperaturë prej 20° C të mos jetë më e vogël se 50,9 %. Mushti i koncentruar i rrushit duhet ekskluzivisht të rrjedhë nga rrushi i klasifikuar për prodhim të verës në Kosovë. Fortësia alkoolike në njësi vëllimore e mushtit të koncentruar të rrushit duhet të jetë jo më shumë se 1% vol.

7) **Mushti i rrushit të rafinuar dhe koncentruar:** prodhimi i lëngshëm i pakaramelizuar i cili fitohet nga dehidrimi i pjesërishëm i mushtit të rrushit i realizuar përmes një metode të autorizuar e ndryshme nga ngrohja e drejtpërdrejtë në mënyrë që vlera e paraqitur në refraktometër në temperaturë prej 20° C të mos jetë më pak se 61,7 %. Kjo i është nënshtruar përpunimit të autorizuar për deacidim dhe eliminim të përbërësve tjerë të ndryshëm nga sheqeri. Fortësia alkoolike në njësi vëllimore të mushtit të koncentruar të rrushit duhet të jetë jo më shumë se 1%.

8) **Lëngu i rrushit:** prodhimi i lëngët i pafermentuar por i fermentueshëm i fituar nga përpunimi përkatës që si i tillë është i gatshëm për konsumim. Mund të fitohet nga rrushi i freskët, mushti i rrushit apo nga rikonstituimi i mushtit të koncentruar të rrushit apo lëngut të koncentruar të rrushit. Fortësia alkoolike në njësi vëllimore e lëngut të rrushit lejohet të jetë jo më shumë se 1%.

9) **Lëngu i koncentruar i rrushit :** lëngu i pakaramelizuar i rrushit i fituar nga dehidrimi i pjesërishëm i lëngut të rrushit i realizuar përmes një metode të autorizuar e ndryshme nga ngrohja e drejtpërdrejtë në mënyrë që vlera e paraqitur në refraktometër në një temperaturë prej 20° C të mos jetë më e vogël se 50,9 %. Fortësia alkoolike në njësi vëllimore e lëngut të koncentruar të rrushit lejohet të jetë jo më shumë se 1%.

10) **Vera e re në fermentim e sipër:** vera në të cilën fermentimi alkoolik nuk ka përfundua dhe që nuk është ndarë akoma nga fundërrina.

11) **Vera shkumbore:** prodhimi i cili përfitohet nga fermentimi i parë apo i dytë alkoolik i rrushit të freskët, mushtit të rrushit apo verës, e cila, posa të hapet paketimi, liron dioksid karboni që ekskluzivisht rrjedh nga fermentimi dhe që ka një shtypje të madhe për shkak të dioksidit të karbonit në tretësirë, prej jo më pak se 3 bar në temperaturë 20° C në paketim të mbyllur.

12) **Vera shkumbore e gazuar:** prodhimi i cili fitohet nga vera dhe kur të hapet paketimi liron dioksid karboni që rrjedhë tërësisht apo pjesërisht nga një shtesë e atij gazi dhe që

ka një shtypje të madhe për shkak të dioksidit të karbonit në tretësirë, prej jo më pak se 3 bar në temperaturë 20° C në kontenjera të mbyllur.

13) **Vera gjysmë shkumbore:** prodhimi i cili fitohet nga vera me fortësi aktuale alkoolike së paku 9% vol; me fortësi të përgjithshme alkoolike në vëllim prej së paku 7% vol. dhe shtypje të madhe për shkak të dioksidit të karbonit endogjen në tretësirë prej jo më pak se 1 bar dhe jo më shumë se 2,5 bar në temperaturë prej 20° C në kontenjera të mbyllur. Vendoset në paketim prej më së shumti 60 litrave.

14) **Vera e gazuar gjysmë shkumbore:** prodhimi i cili fitohet nga vera me fortësi aktuale alkoolike prej së paku 7%, me fortësi përgjithshme alkoolike prej së paku 9% vol; dhe shtypje të madhe prej së paku 1 bar dhe jo më shumë se 2,5 bar në temperaturë prej 20° C në paketim të mbyllur për shkak dioksidit të karbonit në tretësirë që është shtuar tërësisht apo pjesërisht. Vendoset në paketim prej më së shumti 60 litrave.

15) **Uthulla e verës:** uthulla, e cila fitohet ekskluzivisht nga fermentimi acetik i verës dhe ka aciditetin e përgjithshëm prej së paku 60 gram/litër e shprehur si acid acetik.

16) **Vera liker:** prodhimi që ka një fortësi aktuale alkoolike në njësi vëllimore prej së paku 15% dhe jo më shumë se 22% dhe një fortësi të përgjithshme alkoolike në njësi vëllimore prej së paku 17,5%. Fitohet nga mushti i rrushit në fermentim ose vera apo kombinimi i tyre me shtesa individuale apo në kombinim me alkoolin neutral me prejardhje nga vera dhe verës apo destilati i rrushit të tharë me fortësi aktuale alkoolike prej së paku 52% vol. dhe jo më shumë se 86%. Mund të shtohet mushti i koncentruar i rrushit.

17) **Fundërrina e verës:** mbetja e grumbulluar pas fermentimit në enë dhe që përmban verë apo musht të rrushit, gjatë ruajtjes apo pas trajtimit të autorizuar dhe mbetja e fituar nga filtrimi apo centrifugimi i këtyre prodhimeve.

18) **Bërsia e rrushit:** masa nga bluarja e rrushit të freskët, e fermentuar apo e pa fermentuar.

19) **Cipura e rrushit:** Prodhimi i fituar nga fermentimi i bërsisë së rrushit të papërpunuar e tretur në ujë apo duke kulluar bërsinë e rrushit të fermentuar me ujë.

20) **Vera e dedikuar për destilim:** prodhimi i cili ka një fortësi aktuale alkoolike në njësi vëllimore prej së paku 18% dhe jo më shumë se 24%, fitohet ekskluzivisht si shtesë në verë dhe që nuk përmban sheqer të tepërt të një prodhimi të parafinuar që rrjedh nga destilimi i verës dhe që ka fuqi aktuale alkoolike maksimale prej 86% në njësi vëllimore dhe aciditet maksimal avullues prej 1,5 gram/litër, e shprehur si acid acetik.

21) **Verë cilësore:** verë e prodhuar në zonat vreshtare, të një rajoni të specifikuar për prodhimin e verës cilësore.

22) **Verë rajonale:** verë e prodhuar në zonat për kultivim të hardhisë për verë rajonale.

23) **Ministria** është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

(24) **Person:** është çdo subjekt fizik ose juridik.

(25) **Paketimi:** është vënia dhe mbyllja e verës dhe produkteve tjera në shishe, kontenjera, fuçi të drurit ose material tjetër me qëllim të deponimit, ruajtjes dhe mbrojtjes së vetive fizike, kimike dhe organoleptike të tyre.

(26) **Mbushësi** është personi që realizon mbushjen apo që e ka realizuar në emër të tyre.

27) **Mbushja** do të thotë vendosja e prodhimit përkatës për qëllime komerciale në paketim me një kapacitet që nuk tejkalon 60 litra.

### Prejardhja gjeografike Neni 3

3.1. Prejardhja gjeografike e verës dhe prodhimeve tjera caktohet sipas territorit gjeografik në të cilin prodhohet rrushi dhe ku vera e prodhimet tjera kanë fituar karakteristika përkatëse si rrjedhojë e kushteve natyrore apo aktiviteteve njerëzore.

3.2. Prejardhja gjeografike e verës përcaktohet sipas:

- a) një lokaliteti të vogël apo disa lokaliteteve;
- b) një zone administrative lokale apo pjese të saj;
- c) një nën-rajoni vreshtar apo pjesëve të tij;
- d) një rajoni ;
- e) një “rajoni specifik”

3.3. Përcaktimi i prejardhjes gjeografike është e drejtë kolektive dhe mund të shfrytëzohet për verën dhe prodhimet tjera të cilat janë të regjistruara në Regjistrin e Kultivuesve të Rrushit dhe Verës, duke siguruar që rrushi, vera dhe prodhimet tjera janë prodhuar në territorin përkatës dhe i plotësojnë kriteret e përcaktuara.

3.4. Për të mbrojtur dhe kontrolluar prejardhjen gjeografike të verës dhe prodhimeve tjera, në pajtim me këtë ligj, duhet të mbahet lista e emërtimeve gjeografike të verës dhe prodhimeve tjera. Për këtë qëllim territori vreshtar në Kosovë është i ndarë në dy rajone vreshtare.

### Autoritetet kompetente Neni 4

4.1. Ministria drejtpërdrejtë apo nëpërmjet trupave të saj (Institucioneve të autorizuara):

- a) mbanë regjistrin e vreshtave;
- b) mbajnë Regjistrin e Kultivuesve të Rrushit dhe Verës;
- c) përcakton varietetet e rekomanduara dhe të lejuara të hardhisë dhe nënshartesave të saj;
- d) përcjellë pjekjen e rrushit dhe përcakton kohën e vjeljes;
- e) kufizon rendimentet maksimale të rrushit për hektarë, varësisht prej varietetit dhe destinimit;
- f) vlerëson dhe përcakton verën dhe prodhimet e tjera.

4.2. Nëpërmjet institucioneve të autorizuara profesionale, administrative, promovuese dhe analitike në vreshtari dhe prodhim të verës, të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerrura në pajtim me këtë ligj do të bëjë:

- a) arsimimin, trajnimin si dhe ofrimin e njohurive për kultivuesit e rrushit dhe prodhuesit e verës për çështjet teknologjike, ekonomike, ekologjike dhe fushat tjera të rëndësishme për zhvillimin e vreshtarisë dhe prodhimit të verës;
- b) përzgjedhjen e hardhive;
- c) rritjen e sigurisë së furnizimit të mjaftueshëm të materialit bazë për hardhi;

- d) Përcjelljen e teknologjive të përcaktuara dhe metodave për prodhimin e rrushit dhe verës;
- e) vlerësimin e rrushit dhe verës dhe klasifikimin e verës dhe prodhimeve tjera sipas cilësive të tyre (analizave laboratorike dhe vlerësimeve organoleptike);
- f) lëshimin e çertifikatave për vlerësimin e verës dhe prodhimeve tjera.

4.3. Komunitet mbajnë regjistrin kadastral të ngastrave ekzistuese dhe ngastrave të mundshme të vreshtarisë në territore të klasifikuara për vreshtari. Një kopje të regjistrave kadastral të ngastrave vreshtare si dhe ndryshimet e mëvonshme që bëhen në to, Komuna duhet t'ia dërgoi Ministrisë.

## KAPITULLI II PRODHIMI I RRUSHIT DHE VERES

### Prodhimi Neni 5

5.1. Prodhimi i verës nënkupton të gjitha aktivitetet e ndërmarrura në vreshtë duke përfshirë vjeljen, përpunimin dhe ripërpunimin e rrushit dhe të gjitha aktivitetet në proceset enologjike.

5.2. Vera dhe prodhimet tjera mund të prodhohen vetëm nga personat që janë të regjistruar në regjistrin e kultivuesve të rrushit dhe prodhuesve të verës.

5.3. Kultivuesit e rrushit janë persona juridik apo fizik që kultivojnë rrushin për prodhim të verës apo prodhime tjera dhe të cilët:

- a) posedojnë, marrin me qira apo mbajnë (shfrytëzojnë) në ndonjë mënyrë tjetër vreshtë prej së paku 0,05 ha në territorin e Kosovës ose vreshtë më të vogël se 0,05 ha, nëse rrushi, vera apo prodhimet tjera vihen në treg;
- b) kanë banim të përhershëm në Kosovë dhe posedojnë apo marrin me qira vreshtë në rajone kufitare rreth Kosovës, duke siguruar që e transferojnë rrushin, verën dhe prodhimet tjera në Kosovë.

5.4. Prodhuesit e verës dhe të prodhimeve tjera janë persona që prodhojnë verën apo produktet tjera nga rrushi të cilin e kultivojnë vetë apo nga rrushi i blerë.

5.5. Përpunuesit e verës dhe prodhimeve tjera janë persona të cilët përpunojnë verën apo prodhime tjera vetanake apo të blera në prodhime të reja.

### Regjistri i kultivuesve të rrushit dhe prodhuesve të verës Neni 6

6.1. Ministria mbanë shënime mbi personat të cilët kultivojnë rrushin, prodhojnë dhe përpunojnë verën apo prodhime tjera.

6.2. Prodhuesit apo përpunuesit e rrushit, verës apo prodhimeve të tjera duhet të regjistrohen në Ministri.

### 6.3. Regjistri duhet të përmbajjë këto të dhëna:

- a) për prodhuesit apo përpunuesit: emri, mbiemri dhe adresa, numri personal i personit fizik, emri selia dhe numri i regjistrimit të biznesit të personit juridik apo një ndërmarrësi të pavarur;
- b) për vreshta: njësia kadastrale, komuna kadastrale dhe numri kadastral i ngastrës, radhitja kadastrale dhe sipërfaqja neto dhe bruto e ngastrës;
- c) për hardhi: numri dhe dendësia e hardhive, varietetet, nënshartesat dhe viti i mbjelljes;
- d) për rendimentet: sasi të rrushit për varietetet, sasi të verës dhe prodhimeve tjera vetanake;
- e) për furnizim: sasia e rrushit, mushtit apo verës e çdo lloji të blerë, sasia e prodhimeve tjera të blera sipas llojit dhe origjinës.

6.4. Prodhuesi apo përpunuesi i rrushit, verës apo prodhimeve tjera i cili veç ushtron këtë veprimtari, duhet të aplikojë për t'u regjistruar në regjistër. Prodhuesi apo përpunuesi i rrushit, verës apo prodhimeve tjera i cili kërkon të fillojë me këtë veprimtari, duhet të aplikojë paraprakisht për t'u regjistruar në regjistër. Aplikacioni duhet të bëhet sipas mënyrës dhe afatit të përcaktuar dhe t'i bashkëngjitet dokumentacioni i kërkuar sipas aktit nënligjor të nxjerrur nga Ministria.

## Regjistri i vreshtave

### Neni 7

7.1. Për hartimin e regjistrimit të vreshtave, Ministria përveç regjistrimit qendror shfrytëzon edhe burime tjera të të dhënave, të cilat ofrojnë shënime mbi vreshtat ekzistuese dhe ato të mundshme. Regjistri i vreshtave mbahet së bashku me regjistrin kadastral.

7.2. Vetëm sipërfaqet e përshtatshme për kultivimin e vreshtave mund të regjistrohen si vreshta të mundshme. Sipërfaqe e përshtatshme vreshtare është një sipërfaqe e tokës në të cilën rrushi i kultivuar për qëllim të prodhimit të verës do të rezultojë në rendimente optimale cilësore dhe sasiore dhe do të jetë më fitimprurëse se sa kultivimi i çfarëdo kulture tjetër bujqësore.

7.3. Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrimit të vreshtave, Ministria do të shfrytëzojë të dhënat në vijim:

- a) për prodhuesit: nga regjistri qendror i kultivuesve të rrushit dhe verës dhe atë: për persona fizik emri, mbiemri, selia dhe numri personal nga regjistri qendror i qytetarëve ndërsa për persona juridik emri, adresa, shifra veprimtarisë dhe shënime tjera nga regjistri i zyrës për regjistrimin e bizneseve. Gjithashtu është e lejueshme të konsultohet regjistri i njërive territoriale dhe të dhënat e numrit të shtëpive në mënyrë që të merren shënime e nevojshme.
- b) për pozitën e vreshtave shënimet mbi regjistrin kadastral, planet topografike, hartat dhe baza e të dhënave e cila merret nga komunat.

7.4. Mbajtësit apo pronarët e të dhënave duhet të sigurojnë shënime për Ministrinë pa kompensim, përveç në rastet e shpenzimeve direkte për kopje shtesë.

## Rrushi Neni 8

8.1. Rrushi për prodhimin e verës mund të kultivohet vetëm në vendet e regjistruara të vreshtarisë, duke shfrytëzuar vetëm varietetet e rekomanduara dhe të autorizuar të rrushit siç është përcaktuar për njësinë territoriale përkatëse vreshtare.

8.2. Rrushi për qëllim të prodhimit të verës duhet të kultivohet me teknologji të përkatëse për kategorinë cilësore të përcaktuar të verës.

8.3. Në prodhimin e rrushit dhe verës, përpunimi i rrushit, lëngu i rrushit, mushtit dhe verës duhet të ruaj dhe zhvillojë të gjitha karakteristikat natyrore cilësore të rrushit, duke rezultuar në verën e përshtatshme për konsumim.

8.4. Ndalohet prodhimi i verës nga rrushi, lëngu i rrushit apo mushti i importuar. Kjo dispozitë nuk aplikohet për rrushin e prodhuar nga kultivuesit e rrushit në ngastrat të cilat i posedojnë dhe që janë në rajone kufitare me Kosovën, duke siguruar që ata e transferojnë në Kosovë në pajtueshmëri me këtë Ligj dhe me aktet nënligjore të nxjerrura sipas tij.

8.5. Vjelja e rrushit me qëllim të prodhimit të verës me cilësi të lartë duhet të regjistrohet paraprakisht në institucionin e autorizuar nga Ministria. Para vjeljes institucioni e autorizuar kontrollon sasinë dhe cilësinë e rrushit me qëllim të prodhimit të verës së cilësisë së lartë.

8.6. Përrjashtimisht lejohet importimi i mushtit të koncentruar të rrushit, i destinuar vetëm për fisnikërimin e verës cilësore sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara me akt të veçantë nënligjor.

## Klasifikimi i varieteteve të hardhisë Neni 9

9.1. Të gjitha llojet e klasifikuara duhet t'i takojnë llojeve Vitis vinifera apo që vijnë nga kryqëzimi i këtyre llojeve apo llojeve tjera genus vitis. Klasifikimi i varieteteve të hardhisë për prodhimin e verës rregullohet me Udhëzim Administrativ i cili implementon këtë ligj.

9.2. Vetëm ato varietete të hardhisë, të cilat paraqiten në klasifikim mund të mbjellën, rimbjellën apo shartohen brenda territorit të Kosovës për qëllim të prodhimit të verës.

9.3. Zonat e mbjellura me varietet të hardhive me qëllim të prodhimit të verës dhe që nuk janë të përfshira në klasifikim do të shkulen me përjashtim të rasteve ku prodhimi ka për qëllim ekskluzivisht konsumimin nga familjet prodhuese të verës.

9.4. Kur varietetet shlyhen nga klasifikimi shkulja do të bëhet brenda 15 viteve nga dita e shlyerjes së tyre.

## Vera Neni 10

10.1. Pavarësisht nga dispozitat e kapitullit VII prodhimi i rrushit, verës dhe prodhimet tjera të rrushit apo verës duhet të realizohet duke shfrytëzuar vetëm proceset e përcaktuara teknologjike dhe substancat enologjike të lejuara.

10.2. Përmirësimi i mushtit, verës, ëmbëlsimi verës, lëngut të rrushit apo mushtit nuk është e lejuar përderisa institucioni i autorizuar të mos ketë dhënë lejen e kërkuar për sheqerosjen e bërsisë apo mushtit. Institucioni i autorizuar mund të lëshojë lejen nëse koha në vitin përkatës është në mënyrë ekstreme e pafavorshme për rritjen dhe zhvillimin e hardhisë, duke pasur parasysh njësitë territoriale të vreshtarisë dhe cilësinë e paraparë të verës si dhe llojin e rrushit. Ndalohet lëshimi i lejes për ëmbëlsim nëse lëngu i rrushit dhe mushti janë dedikuar për prodhim të verës së cilësisë së lartë.

10.3. Leja e referuar në paragrafin e lartpërmendur aplikohet për të gjithë prodhuesit e rrushit dhe verës të llojit përkatës në njësinë përkatëse territoriale të vreshtarisë, lëshohet në procedurën zyrtare dhe një kopje i dërgohet inspeksionit përkatës.

Përzierja e rrushit, lëngut të rrushit, mushtit dhe verës  
Neni 11

11.1. Përzierja e rrushit, lëngut të rrushit, mushtit apo verës së cilësisë dhe kategorisë së veçantë për vitet dhe ngjyrën e ndryshme të rrushit është e lejuar brenda kufijve të caktuar me këtë Ligj dhe aktet nënligjore të bazuara në të.

11.2. Ndalohet përzierja e verës Kosovare dhe atyre të huaja.

KAPITULLI III  
PRODHIMI I VERËRAVE CILËSORE

Neni 12

Dispozitat e këtij Ligji dhe akteve nënligjore me të cilat zbatohet ky ligj, që kanë të bëjnë me prodhimin e verërave cilësore duhet të bazohen në faktorët në vijim:

- a) Kufizimi i zonës prodhuese (rajonit të specifikuar);
- b) Klasifikimi i varieteteve të hardhisë të përshtatshme për verëra cilësore;
- c) Përshtatja e kultivimit dhe metodave të prodhimit të verës;
- d) Përcaktimi i fortësisë minimale natyrale alkoolike;
- e) Përcaktimi i rendimentit maksimal për hektar;
- f) Analizimi dhe vlerësimi i karakteristikave organoleptike.

Rajoni i specifikuar  
Neni 13

13.1. “Rajoni i specifikuar” do të thotë territor për prodhimin e verës apo kombinim i territoreve për prodhim të verës me karakteristika të veçanta cilësore, emri i të cilës përdoret për të përcaktuar cilësinë e verës.

13.2. Çdo rajon i specifikuar duhet të kufizohet saktësisht, sa të jetë e mundur në bazë të vreshtave të caktuara apo ngastrave. Kufizimi i tillë duhet të ketë parasysh faktorët të cilët ndikojnë në cilësinë e verës së prodhuar në ato rajone, siç janë tipi i tokës, klima dhe gjendja e vreshtave të caktuara apo ngastrave.



13.3. Emri gjeografik, që përcakton një rajon të specifikuar, duhet të jetë mjaft preciz dhe ngushtë i lidhur me zonën e prodhimit.

13.4. Rajonet e specifikuara në Kosovë do të përcaktohen me akt nënligjor i cili nxirret sipas këtij Ligji.

#### Rendimenti

##### Neni 14

14.1. Rendimentet maksimale për hektarë për verën cilësore dhe kategoritë tjera me prejardhje nga Kosova do të përcaktohen me akt nënligjor.

14.2. Shfrytëzimi i prejardhjes gjeografike është i ndaluar për tërë vjeljen, nëse rendimentet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, tejkalohen.

#### Testimi i verës

##### Neni 15

15.1. Për verërat cilësore prodhuesit janë të obliguar të kryejnë testet analitike dhe organoleptike në institucionin e autorizuar nga Ministria. Marrja e mostrave për test bëhet nga inspektorët përkatës.

15.2. Testi organoleptik ka të bëjë me ngjyrën, kthjelltësinë, erën dhe shijen.

15.3. Testi analitik mundëson përcaktimin e faktorëve që kanë të bëjnë me reagimin e verës gjatë testit mikrobiologjik dhe analizave fizike dhe kimike.

15.4. Kufijtë e epërm dhe të poshtëm për këta faktorë përcaktohen me akt nënligjor.

### KAPITULLI IV

### NJESITË TERRITORIALE TË VRESHTARISË

#### Ndarjet e njësive territoriale

##### Neni 16

16.1. Duke e marrur parasysh rrethanat ekologjike si relievin, klimën, tokën, faktorët agrobiologjik dhe shkencorë, komponentët parimore organoleptike të verërave dhe aspektet historike tradicionale të vreshtarisë, territori vreshtar i Kosovës do të ndahet në njësitë territoriale si në vijim: rajonet, nënrajonet, zonat dhe lokalitet vreshtare.

16.2. Rajoni i vreshtarisë është njësi më e madhe territoriale e vreshtarisë me kushte të ngjashme klimatike dhe tokësore të cilat, të kombinuara me faktorët agrobiologjik ndikojnë në karakteristikat themelore organoleptike të verës së prodhuar në atë rajon. Rajonet e vreshtarisë janë Rajoni i Dukagjinit dhe Rrafshit të Kosovës.

16.3. Nënrajonit i vreshtarisë është territori themelor i përcaktuar gjeografikisht, me kushte të ngjashme klimatike dhe tokësore, varietete të caktuara të kultivimit të hardhive dhe faktorë tjerë të ngjashëm agrobiologjik të cilët së bashku mundësojnë prodhimin e rrushit dhe verërave të cilat përmbajnë komponente organoleptike që janë karakteristike për nënrajonin e vreshtarisë.

16.4. Njësitë territoriale të vreshtarisë më të vogla se nënrajonet e vreshtarisë janë zonat e vreshtarisë, dhe lokalitetet e vreshtarisë. Këto janë pjesë të përcaktuara gjeografikisht me kushte të ngjashme klimatike, tokësore, të lartësisë, dhe faktorëve tjerë të mjedisit ku kultivohen varietetet specifike të hardhive të cilat së bashku mundësojnë prodhimin e rrushit dhe verës të ndryshme për nga cilësia dhe komponentet organoleptike nga rrushi dhe vera e prodhuar në njësitë tjera të vreshtarisë të rajonit të njëjtë vreshtar. Nënrajonet, zonat dhe lokalitetet vreshtare do të caktohen me akt nënligjor.

#### Përzgjedhja e hardhive Neni 17

Në zona të caktuara të vreshtarisë lejohet mbjellja e hardhisë së rrushit dhe prodhimi i verës vetëm nga varietetet e përcaktuara.

### KAPITULLI V KLASIFIKIMI DHE VLERESIMI Kategoritë e verërave

#### Neni 18

18.1. Sipas këtij ligji verërat janë:

- a) Vera e qetë,
- b) vera shkumbore,
- c) vera shkumbore e gazuar,
- d) vera gjysmë shkumbore,
- e) vera gjysmë shkumbore e gazuar
- f) verërat aromatike,
- g) verërat liker,
- h) verërat tjera të veçanta.

18.2. Sipas ngjyrës verërat klasifikohen në verëra të bardha, roze dhe të kuqe.

18.3. Sipas përmbajtjes së sheqerit verërat klasifikohen në:

- a) verërat e qeta: të thata, gjysmë të thata, gjysmë të ëmbla dhe ëmbla;
- b) shkumbore, shkumbore e gazuar, gjysmë shkumbor dhe gjysmë e shkumbore e gazuar klasifikohen si: shumë të thata, të thata, gjysmë të thata, gjysmë të ëmbla dhe të ëmbla.

18.4. Kriteret për ndarjen e verërave sipas përmbajtjes së sheqerit:

- a) e thatë: vera që përmban më së shumti 4 gram/litër sheqer reduktues të pafermentuar,
- b) gjysmë e thatë: vera që përmban më tepër se 4 gram/litër por që nuk tejkalon 12 gram/litër sheqer redukues të pa fermentuar,

- c) gjysmë e ëmbël: vera që përmban më tepër se 12 por që nuk tejkalon 45 gram/litër sheqer redukues të pa fermentuar,
- d) e ëmbël: vera që përmban sheqer redukues të pafermentuar më së paku 45 gram/litër.

18.5. Duke i pasur parasysh dispozitat e Kapitullit III, klasifikimi i verës në klasë cilësore varet nga cilësia e arritur e rrushit, rendimentit për hektar, që nuk duhet të tejkalojë kufijtë e përcaktuar paraprakisht, përmbajtjen e sheqerit, përmbajtjen natyrale alkoolike dhe përbërësit tjerë si dhe komponentët organoleptike të verës, ndahen si në vijim:

a). verëra tryeze :

- verë tryeze,
- verëra tryeze me prejardhje gjeografike.

b). verërat cilësore me prejardhje gjeografike të çertifikuara dhe të mbrojtura

- verë cilësore,
- verë kulminante, e cila është klasifikuar sipas pjekurisë së rrushit dhe metodës së vjeljes apo vjetërsisë së verës.

c). Verërat shkumbore:

- verërat shkumbore të tryezës,
- verërat rajonale shkumbore,
- verërat cilësore shkumbore .

d). Verërat gjysmë shkumbore:

- Verërat gjysmë shkumbore të tryezës,
- Verërat cilësore gjysmë shkumbore

#### Vlerësimi i verës cilësore

##### Neni 19

19.1. Duke i pasur parasysh dispozitat e kapitullit III, vera cilësore dhe mushti i përshtatshëm për verëra cilësore, të destinuar për treg duhet të vlerësohen duke zbatuar procedurën e përcaktuar, para se të plasohen në treg. Vera cilësore e destinuar për treg nuk duhet të ndryshohet pasi të jetë vlerësuar zyrtarisht. Nëse vera cilësore ka ndryshuar për çfarëdo arsye pas vlerësimit, duhet të bëhet vlerësim i ri para se të plasohet në treg.

19.2. Verërat e importuara duhet ti nënshtrohen vlerësimit.

19.3. Verërat e importuara vlerësohen për të përcaktuar pajtueshmërinë me dokumentet përcjellëse dhe çertifikatën e lëshuar nga vendi i eksportuesit dhe përshtatshmërinë e tyre për plasim në tregun e Kosovës.

19.4. Ankesa në vlerësim mund të paraqitet brenda tetë ditëve nga dita e marrjes së vlerësimit, në Ministri. Rezultatet e vlerësimit të dytë janë përfundimtare.

## Etiketa e kontrollimit Neni 20

- 20.1. Etiketa e verës cilësore që vihet në treg duhet të përmbaj edhe etiketën e veçantë për kontroll të cilësisë.
- 20.2. Institucioni i autorizuar lëshon etiketën e kontrollit të cilësisë për sasinë e verës të cilën e ka dorëzuar prodhuesi për vlerësim dhe e cila është vlerësuar pozitivisht.
- 20.3. Institucioni i autorizuar mban shënimet e përcaktuara për etiketën e kontrollit të lëshuar.

## Komisioni shijues (degustues)-testues Neni 21

- 21.1. Vlerësimi organoleptik i cilësisë së verës realizohet nga komisioni prej më së paku pesë anëtarësh, që përfaqësojnë kultivuesit e rrushit, prodhuesit e verës, konsumatorët dhe ekspertët nga lëmi i vreshtarisë dhe prodhimi i verës.
- 21.2. Në rast të kërkesës për vlerësim tjetër plotësues, anëtarët e komisionit të parë nuk mundë të marrin pjesë në vlerësimin e dytë. Vlerësimi i dytë bëhet nga një komision prej nëntë anëtarëve.
- 21.3. Shijuesit për vlerësim organoleptik të verës dhe mushtit emërohen nga Ministri.
- 21.4. Para emërimit, shijuesi duhet të kontrollohet për aftësitë e tija të shijimit, dhe të njoh enologjinë dhe rregullat mbi vreshtarinë dhe prodhimin e verës.
- 21.5. Nëse shijuesi është prodhues apo punëtor i një subjekti që prodhon verë apo musht, vlerësimi i tij nuk merret parasysh kur vera apo mushti i vlerësuar janë prodhime të tija vetanake apo janë të prodhuara nga subjekti në të cilën ai punon.

## KAPITULLI VI ETIKETIMI

### Neni 22

- 22.1. Etiketimi do të thotë të gjitha përshkrimet dhe referencat tjera, simbolet, ilustrimet apo shenjat të cilat shërbejnë për të dalluar prodhimin që paraqitet në paketim, duke përfshirë mbylljen, apo shenjat në paketim.
- 22.2. Të dhënat obligative të etiketës, përveç numrit të kontigjentit, duhet të shënohen në fushën e njëjtë vizuale në paketim dhe të jenë të lexueshme, me shkronja të pashlyeshme, të mëdhaja që dallohen nga të tjerat.
- 22.3. Para plasimit të prodhimit në treg të gjitha paketimet duhet të jenë të etiketuara. Etiketimi duhet të jetë në pajtim me dispozitat e këtij ligji apo akt nënligjor që nxirret sipas këtij ligji.

## Neni 23

23.1. Të dhënat e paraqitura në etiketë duhet të jenë të sakta dhe të mos e çorientojnë konsumatorin.

23.2. Këto të dhëna duhet të pasqyrojnë karakteristikat e verës dhe prodhimeve tjera si: përbërjen, përmbajtjen alkoolike, ngjyrën, cilësinë, llojin e rrushit dhe vitin e vjeljes, të dhënat e personave të cilët kanë qenë të përfshirë në prodhim apo qarkullim e në veçanti të dhënat për mbushësin e shisheve.

## Të dhënat e obligueshme

### Neni 24

Të dhënat e obligueshme për verën e tryezës, verën e tryezës me karakteristika gjeografike dhe verërat cilësore janë:

- a) emri tregtar;
- b) prejardhja gjeografike
- c) vëllimi ;
- d) fortësia aktuale alkoolike në njësi vëllimore;
- e) tipi i verës;
- f) emri i personit dhe adresa e mbushësit të shisheve e për paketimet me vëllim prej më së shumti 60 litra, distributori.
- g) numri i vlerësimit vetëm për verëra cilësore.

## Të dhënat jo obligative

### Neni 25

25.1. Të dhënat joobligative për verën e tryezës, verën për tryeza me karakteristika gjeografike dhe verërat cilësore janë:

- a) emri dhe adresa e personave të cilët kanë marrur pjesë në marketing;
- b) lloji i prodhimit;
- c) ngjyra përkatëse.

25.2. Të dhënat joobligative për verërat për tryeza me karakteristika gjeografike dhe verërat cilësore janë:

- a) viti i vjeljes;
- b) emri i një apo më shumë varieteteve;
- c) shpërblimi apo medaljet e fituara në gara;
- d) të dhënat për lëndën e parë, mjetet apo metodat e shfrytëzuara për prodhimin e produktit;
- e) të dhënat tjera tradicionale;
- f) të dhënat se vera është mbushur në pronë.

25.3. Të dhënat joobligative për verërat cilësore:

- a) Të dhënat për zonën gjeografike më të vogël apo më të madhe se sa rajoni i specifikuar;
- b) Të dhënat që mbushja është bërë në rajon të specifikuar.

25.4. Etiketimi mund të plotësohet me karakteristika tjera, duke siguruar që janë të sakta dhe nuk çorientojnë konsumatorin.

#### Gjuhët Neni 26

26.1. Të dhënat në etiketë duhet të paraqitet në gjuhën në të cilën konsumatori e kupton lehtë.

26.2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni karakteristikat gjeografike dhe nocionet tradicionale mund të paraqiten vetëm në gjuhët zyrtare në Kosovë.

#### Emri i produktit Neni 27

27.1. Emri i produktit në etiketë nuk duhet të përmbajë asnjë fjalë, pjesë të fjalës, shenjë apo ilustrim që mund të shkaktojë konfuzion apo çorientojë konsumatorin.

27.2. Etiketa nuk mund të ketë emrin e produktit i cili përmban fjalë, pjesë të fjalëve, shenja apo ilustrime, me informata të pavërteta veçanërisht në lidhje me prejardhjen gjeografike, llojin e verës, vitin e vjeljes apo referencën për cilësi kulminante.

#### Përmbajtja alkoolike Neni 28

28.1. Fortësia aktuale alkoolike në njësi vëllimore duhet të shënohet në njësi apo gjysmë njësi përqindjeje. Fortësia e paraqitur nuk mund të dallon për më shumë se 0,5 % vol. nga ajo e paraqitur në analizë.

28.2. Shifra duhet të jetë “% vol.” dhe mund të paraprihet nga “fortësia aktuale alkoolike”, “alkooli aktual” apo “alk.”.

28.3. Fortësia aktuale alkoolike shënohet në etiketë me shifra prej më së paku 5 mm të larta nëse vëllimi formal është mbi 100 cl, më së paku 3 mm të larta nëse vëllimi është barazi apo më pak se 100 cl por më e madhe se 20 cl dhe 2 mm lartësi nëse vëllimi është deri 20 cl .

#### Mbushësi, paketuesi Neni 29

29.1. Shënimi për mbushësin duhet të plotësohet me fjalët “mbushësi” apo “ e mbushi”. Në rast të mbushjes kontraktuese, shënimi për mbushësin duhet të plotësohet me fjalët “mbushësi” apo kur mbushja bëhet në emër të palës së tretë duhet të plotësohet me fjalët “e mbushur për ... nga ...”.

29.2. Për paketimet e ndryshme nga shishet, fjalët “paketuesi” dhe “e paketoj” zëvendësojnë fjalët “mbushësi” dhe “E mbushi”.

29.3. Vera the prodhimet tjera që u referohet ky ligj dhe Udhëzimet Administrative që nxirren sipas tij nuk duhet mbyllur me mbyllës plumbi me bazë plumbi apo materialet tjera që janë të dëmshme për shëndetin e njeriut.

## Treguesit e aktiviteteve Neni 30

30.1. Shënimet për mbushësin, distributorin apo personin e përfshirë në marketing duhet të shoqërohet nga një e dhënë që tregon mbi aktivitetin e tij duke shfrytëzuar shprehjet si “kultivues i rrushit”, “e vjelur nga”, “tregtari”, “shpërndan” apo shprehje të ngjashme.

30.2. Këto veçori joobligative mund të shfrytëzohen vetëm me marrëveshjen e personit të interesuar.

30.3. Kriteret për vënien e shënimeve në etiketë për vitin e vjeljes, varietetet e hardhive, medaljet e fituara dhe emrat tradicional, do të rregullohen me akt nënligjor.

## Prejardhja gjeografike Neni 31

31.1. Prejardhja gjeografike mund të vendoset vetëm në verërat e kategorive të caktuara të prodhuara në territorin e rajonit të caktuar vreshtar dhe posedojnë karakteristika specifike të asaj njësie territoriale të vreshtarisë,

31.2. Vetëm emrat e përcaktuar të njësisë territoriale të vreshtarisë mund të përdoren për emërtimin e prejardhjes gjeografike të verërave.

31.3. Emri i rajonit të vreshtarisë është përdorur për emërimin e verës rajonale; emri i zonës së vreshtarisë apo njësisë më të vogla vreshtare është përdorur për përcaktimin e verërave cilësore.

31.4. Emërimi i verës me cilësi të caktuar me emrin e njësisë territoriale të vreshtarisë parandalon përdorimin e emrit të njëjtë për përcaktimin e verërave me klasë të cilësisë tjetër.

31.5. Përcaktimi i prejardhjes gjeografike duhet të jetë komponenta më e rëndësishme e etiketës.

31.6. Nëse emri i biznesit të ndonjë ndërmarrjeje të përfshirë në marketingun e verërave, përmban referenca gjeografike, atëherë ky emër duhet të vendoset në etiketë vetëm në shkronja më pak të dukshme dhe në atë mënyrë që të mos ketë lajthitje sa i përket prejardhjes gjeografike të verës.

31.7. Nëse shenja tregtare e verës aludon në term gjeografik të qartë apo të nënkuptueshëm atëherë ajo shenjë mund të përdoret vetëm nëse vera është prodhuar në territor të referuar në mënyrë të qartë apo të nënkuptueshëm nga shenja tregtare.

31.8. Në rast të emrave të njëjtë gjeografik, të dy territoreve gjeografike duhet të definohen në mënyrë mjaft të saktë, që të pamundësohet lajthitja sa i përket prejardhjes gjeografike.

## KAPITULLI VII PRAKTIKAT DHE PROCESET ENOLOGJIKE

### Neni 32

32.1. Praktikrat dhe proceset enologjike nga ky Ligj dhe akteve nënligjore përdoren për qëllime të sigurimit të procesit përkatës të prodhimit të verës, ruajtjes dhe ngritjes së cilësisë së prodhimeve.

32.2. Vetëm rrushi i cili i takon varieteteve të caktuara me akt nënligjor, mund të përdoret për prodhimin e verës për tryeza, verës rajonale, verës cilësore dhe prodhimeve tjera..

32.3. Vera e bardhë nuk duhet të përzihet me verën e kuqe.

32.4. Lënda e parë për prodhimin e verës që nuk ka prejardhje nga Kosova nuk mund ti nënshtrohen procesit të fermentimit brenda territorit të Kosovës apo ti shtohen verës së Kosovës përveç rasteve të lejuara me këtë ligj dhe në rastet kur përdoret si shtojcë me lëndën e parë nga Kosova për prodhimin e verës. Përzierja e verës kosovare me verën e cila nuk ka prejardhje nga Kosova është e ndaluar në territorin e Kosovës.

32.5. Vera dhe prodhimet tjera të verës të prodhuara në Kosovë apo të importuara, të cilat nuk u janë nënshtuar praktikave enologjike të autorizuara, që nuk janë të njohura apo kanë cilësi të dobët dhe nuk janë në pajtueshmëri me këtë ligj apo akte nënligjore nuk mund të ofrohen apo ekspozohen për konsumim të drejtpërdrejtë nga konsumatorët.

### Përmbajtja e Dioksid Sulfurit

#### Neni 33

33.1. Përmbajtja e përgjithshme e Dioksid Sulfurit të verës për tryeza, verës rajonale dhe verës cilësore, në plasimin e tyre në treg për konsumim, nuk mund të kalon më shumë se 160 mg/lit. për vera e kuqe dhe 210 mg/lit. për verën e bardhë dhe roze.

33.2. Pavarësisht nga paragrafi 1, maksimumi i përmbajtjes së Dioksid Sulfurit nuk mund të kalon më shumë se 210 mg/lit. për verën e kuqe dhe jo më shumë se 260 mg/lit. për verën e bardhë dhe roze, sa i përket verërave me përmbajtje të tepërt të sheqerit, të shprehur si sheqer redukues, jo më pak se 5 gram / litër.

33.3. Për verërat kulminante me përmbajtje të tepërt të sheqerit si dhe prodhimeve tjera, limitet përcaktohen me akt nënligjor.

### Përmbajtja e acideve avulluese

#### Neni 34

34.1. Përmbajtja maksimale e acideve avulluese nuk mund të kalon më shumë se 18 ml/ekuivalent për një litër për mushtin e rrushit në fermentim, 18 ml/ekuivalent për litër për verën e bardhë dhe roze, 20 ml/ekuivalent për verën e kuqe.

34.2. Për verërat e caktuara, posaçërisht verërat kulminante, të cilat janë pjekur- maturuar gjatë një periudhe së paku dy vjeçare, ose janë prodhuar sipas metodave speciale, si dhe verërat me fortësi alkoolike prej së paku 13 % vol., me përjashtim të atyre nga paragrafi 1, përcaktohen me akt nënligjor.



## Kufijtë e përforcimit

### Neni 35

35.1. Kur kushtet klimatike e bëjnë të nevojshme, institucioni i autorizuar nga Ministria mund të lejon rritjen e fortësisë natyrore alkoolike të rrushit të freskët, mushtit të rrushit në fermentim dhe verës së re në fermentim e sipër.

35.2. Rritja e fortësisë natyrore alkoolike në njësi vëllimore mund të mos lejohet për prodhimet e specifikuar në paragrafin 1 përveç nëse minimumi i fortësisë natyrore alkoolike është nën 7,5 % vol.

35.3. Rritja në fortësisë natyrore alkoolike nuk mund të tejkalon 2 % vol.

35.4. Rritja e fortësisë natyrore alkoolike e shprehur në njësi vëllimore mund të ketë efekt vetëm sa i përket rrushit të freskët, mushtit të rrushit në fermentim dhe verës së re e cila ende gjendet në proces të fermentimit, me ëmbëlsimin, mushtit të koncentruar të rrushit apo mushtit të rrushit të rafinuar dhe koncentruar, ose pjesërisht të koncentruar.

35.5. Në asnjë rast, proceset e lartpërmendura nuk duhet të ndikojnë në rritjen e fortësisë të përgjithshme alkoolike më shumë se 13.5% vol.

## Rritja apo zvogëlimi i aciditetit

### Neni 36

36.1. Rrushi i freskët, mushti i rrushit, mushti i rrushit në fermentim dhe vera mund t'iu nënshtrohen acidimit dhe deacidimit.

36.2. Acidimi i prodhimeve të tilla, të ndryshme nga vera, mund të kryhet vetëm deri në shkallen prej 1,5 gr/lit. shprehur si acid tartaric, apo 20 ml/ekuivalent për litër. Acidimi i verës mund të kryhet vetëm deri në shkallen prej 2,5 gr/lit. shprehur si acid tartaric, apo 33 ml/ekuivalent për litër.

36.3. Deacidimi i verës mund të kryhet vetëm deri në shkallen prej 1,0 gr/lit shprehur si acid tartaric apo 13,3 ml/ ekuivalent për litër.

36.4. Mushti i rrushit i destinuar për koncentrim, mund pjesërisht të deacidohet.

36.5. Acidimi dhe deacidimi i verës mund të kryhet vetëm nga subjektet të cilat prodhojnë verë dhe ku është vjelur rrushi i cili përdoret për prodhimin e verës në fjalë;

## Kushtet tjera

### Neni 37

37.1. Pasurimi, acidimi, deacidimi dhe ëmbëlsimi duhet të lajmërohen në Ministri. Kjo vlenë edhe për sasinë e përdorura të: saharozës, mushtit të koncentruar të rrushit apo mushtit të rrushit të koncentruar dhe të rafinuar dhe kjo bëhet nga prodhuesit, mbushësit, përpunuesit, tregtarët me shumicë në të njëjtën kohë dhe vend si për mushtin e rrushit dhe mushtin e rrushit në fermentim apo verëra.

37.2. Pasurimi, acidimi, deacidimi dhe ëmbëlsimi duhet të regjistrohen dhe lëshohen dokumente përkatëse të cilat tregojnë se produktet i janë nënshtuar procesit dhe mund të vihen në qarkullim.

37.3. Pasurimi dhe ëmbëlsimi, i zvogëluar si pasojë e kushteve të veçanta klimatike, mund të bëhen vetëm para datës 1 janar dhe vetëm për prodhimet e rrushit të vjelur para kësaj date.

## KAPITULLI VIII SHITJA

### Neni 38

38.1. Ndalohet vënia në qarkullim dhe shitja e:

- a) Verës së prodhuar nga hibridet klasike dhe prodhimet tjera të cilat përmbajnë alkool nga rrushi i tillë,
- b) Verës së prishur apo të dëmtuar,
- c) Verës me cilësi zyrtarisht të pavlerësuar,
- d) Verës me karakteristika apo prejardhje gjeografike e cila nuk korrespondon me atë që është deklaruar dhe
- e) Verës e cila është përzierje e verërave Kosovare dhe të huaja.

38.2. Prodhuesit e verës si dhe të tjerët të angazhuar në shitjen të verërave janë të obliguar të shënojnë në mënyrë të dukshme paketimet me verë të prishur si dhe menjëherë të raportojnë sasinë e verës së tillë autoriteteve kompetente gjegjësisht inspektorëve përkatës.

### Mbushja dhe etiketimi Neni 39

39.1. Verërat mund t'iu ofrohen konsumatorëve vetëm nëse janë legalisht të mbushura dhe të etiketuara. Verërat janë legalisht të mbushura dhe të etiketuara nëse janë të paketuara dhe të etiketuara në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj dhe akt nënligjor.

39.2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1, mund t'iu ofrohen konsumatorëve verërat:

- a) nga prodhuesit e regjistruar të rrushit apo verërave, nëse ata ofrojnë verërat ose mushtin nga prodhimtaria e tyre në bodrumet e tyre ose afër tyre si dhe janë të licencuara nga institucioni i autorizuar për një aktivitet të tillë.

39.3. Vera dhe prodhimet tjera të mbushura dhe etiketuara në mënyrë legale mund të tregtohet nga personat e autorizuar dhe ndërmarrësit e pavarur të regjistruar për këtë aktivitet, nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara dhe kanë leje për kryerjen e aktivitetit të tillë.

### Dokumentet përcjellëse Neni 40

40.1. Prodhimet nga ky ligj, mund të vihen në qarkullim brenda Kosovës si dhe të eksportohen vetëm nëse posedojnë dokument përcjellës të kontrollit zyrtar.

40.2. Sasia e verës së mbushur dhe etiketuar në mënyrë legale e cila lejohet të transportohet pa dokument shoqërues nuk duhet të kalon mbi 20 litra, përveç në rastet e transportimit të verës vetanake të prodhuar nga bodrumet deri në vendbanimin e përhershëm të prodhuesit.

40.3. Personat apo grupe njerëzish të cilët janë pronar të prodhimeve nga ky ligj për ushtrimin e tregtisë, posaçërisht prodhuesit, mbushësit dhe përpunuesit apo tregtarët janë të obliguar të mbajnë regjistrin e brendshëm dhe të jashtëm për këto prodhime.

40.4. Regjistri duhet të pasqyrojë të dhënat e nevojshme lidhur me cilësinë, sasinë si dhe prejardhjen gjeografike të mushtit dhe verërave në bodrume. Gjithashtu, duhet të mbahen të dhënat lidhur me verën për qëllim të konsumit privat.

40.5. Rregullat lidhur me dokumentet shoqëruese dhe regjistrat të brendshëm dhe të jashtëm përcaktohen me akt nënligjor.

#### Zonat përpunuese të verës cilësore Neni 41

41.1. Vera cilësore mund të prodhohet vetëm me përpunimin e rrushit në musht të rrushit dhe me përpunimin e mushtit, duke fituar verën brenda rajonit përkatës ku rrushi është vjelur.

41.2. Pavarësisht nga paragrafi 1, Ministria me kërkesën e prodhuesit të rrushit apo verës, mund të lëshon leje të veçantë, për sasinë e caktuar të verës, për prodhimin e verës cilësore në zonën e afërt me rajonin në të cilin rrushi është rritur nëse:

- a) objektivist është e pamundur prodhimi apo paketimi i verës nëpër bodrume të verës brenda rajonit të caktuar në të cilin është rritur rrushi, apo,
- b) kultivuesi i rrushit kultivon rrushin në dy apo më shumë rajone të caktuara.

#### Afati kohor Neni 42

Verërat cilësore mund të plasohen në treg pas 15 dhjetorit të vitit kur rrushi është vjelur. Verërat kulminante dhe të veçanta mund të plasohen në treg pas 31 janarit të vitit vijues.

#### Importi Neni 43

43.1. Verërat dhe prodhimet e tjera, të importuara me qëllim shitjeje në Kosovë, sa i përket cilësisë dhe etiketimit duhet të përputhen më këtë ligj si dhe aktet nënligjore të nxjerrura sipas tij dhe duhet të shoqërohen me çertifikatë të vendit eksportues përfshirë edhe vlerësimin analitik nga institucioni i autorizuar i vendit eksportues. Nëse ndonjë prodhim i posaçëm nuk trajtohet nga ligjet dhe aktet nënligjore të Kosovës, ai duhet të jetë në pajtim me rregulloret në fuqi të vendit eksportues.

43.2. Vera e importuar me shumicë duhet të mbushet para se të tregtohet deri te konsumuesi përfundimtar.

43.3. Çertifikata e vendit eksportues apo vlerësimi analitik i institucionit të autorizuar të vendit eksportues, duhet të përmbajë: emrin e vendit eksportues, përcaktimin eventual të prejardhjes gjeografike, shënimet lidhur me cilësinë, shënimet analitike dhe organoleptike.

43.4. Çdo dërgesë verërave të importuara përveç verës së mbushur në shishe deri në sasinë të cilën një individ mund të importoj pa doganë në pajtueshmëri me rregullat doganore, duhet të mostrohet zyrtarisht nga Inspektori përkatës i cili i dorëzon mostrat Institutit të autorizuar, përveç nëse vendoset ndryshe me anë të ndonjë marrëveshje ndërkombëtare. Instituti i autorizuar vlerëson verërat e importuara brenda katër ditëve pas pranimit të mostrave, përveç në raste kur ndryshe është përcaktuar me marrëveshje ndërkombëtare.

43.5. Importuesi nuk duhet të fillon shitjen komerciale të verërave të importuara në vend para marrjes së vlerësimit.

43.6. Nëse rezultatet e vlerësimit të verërave të kryera nga instituti i autorizuar nuk janë në përputhshmëri me cilësinë ose prejardhjen gjeografike të shtypura në çertifikatë të vendit eksportues, importuesi mund të zgjedh të:

- a) Kthen verërat, ose
- b) Pajis verën me çertifikatë të duhur dhe vlerësim analitik nga vendi eksportues, ose
- c) Përdor verërat për prodhimin e prodhimeve tjera duke siguruar përmbushjen e kushteve të kërkuara.

43.7. Nëse gjatë vlerësimit verifikohet se cilësia e verës nuk përmbush kriteret e përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore të Kosovës, importuesi mund të:

- a) Kthen verën, ose
- b) Përdorë verën për prodhimin e prodhimeve tjera duke siguruar përmbushjen e kushteve të kërkuara apo lejon që në mënyrë të sigurt të asgjësohen.  
Vlerësimi i verës së importuar i nënshtrohet procedurave të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore në fuqi të nxjerrura sipas tij për verën e prodhuar në Kosovë.

43.8. Rregullat për importin e verës do të përcaktohen me një akt nënligjor.

## Eksporti Neni 44

44.1. Verërat e dedikuara për eksport duhet të përmbushin të gjitha kriteret e specifikuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerrura sipas tij, si dhe të gjitha kriteret e imponuara nga ligji i vendit importues.

44.2. Çdo porosi e verës për eksport duhet të shoqërohet me çertifikatë me anë të së cilës institucioni i autorizuar konfirmon cilësinë dhe prejardhjen e dëshmuar gjeografike.

44.3. Pavarësisht nga paragrafi i mëparshëm, sasi të vogla të verës së njëjtë deri në 100 litra, ose të gjitha së bashku jo më shumë se 500 litra, me qëllim të prezantimit, mund të eksportohen pa u vlerësuar fare.

44.4. Vera cilësore duhet të eksportohet legalisht e mbushur dhe e etiketuar.

## KAPITULLI IX INSPEKTIMI

### Inspektorët Neni 45

45.1. Mbikëqyrja dhe implementimi i dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerrura sipas tij, do të kryhet nga shërbimi i inspektionit përkatës i Ministrisë.

45.2. Inspektori përkatës përveç kushteve të përcaktuara me ligjin mbi inspektionin dhe këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerrura sipas këtij ligji duhet të ketë përgatitje përkatëse, përvojë pune dhe të jetë i trajnuar në lëmin e prodhimit të verërave.

### Autorizimet Neni 46

46.1. Inspektorët janë të autorizuar të kontrollojnë:

- a) vreshtat;
- b) hapësirat për përpunim si bodrumet e verës apo stacionet mbushëse etj;
- c) depot të përdorura për magazinimin e rrushit, verës apo prodhimeve tjera;
- d) objektet ku rrushi, vera, mushti, prodhimet tjera dhe substancat enologjike të dedikuara për treg, prodhohen, përpunohen apo magazinohen;
- e) importimin, deponitë doganore në prezencë të doganierit;
- f) hapësirat, në të cilat shiten rrushi, vera mushti dhe prodhimet tjera dhe mjetet transportuese;
- g) pajisjet për prodhim, përpunim, ruajtje, mbushje dhe magazinim të rrushit, mushtit, verës dhe prodhimeve tjera;
- h) rrushin, verën dhe prodhimet tjera në hapësirat prodhuese, automjetet transportuese dhe vendet ku ato shiten;
- i) substancat enologjike;
- j) etiketat;
- k) dokumentet shoqëruese dhe të dhënat e budrumit të verës;
- l) regjistrin e kultivuesve të rrushit dhe verës si dhe regjistri i vreshtave;
- m) dokumentet tjera rreth rrushit, verës dhe prodhimeve tjera të mbajtura nga prodhuesit, përpunuesit, furnizuesit e ushqimeve dhe tregtarët.

46.2. Inspektorët janë të autorizuar të marrin masat në vijim:

- a) urdhërojnë shkëlqen e të gjitha cungjeve të hardhive në ngastrën e mbjellur me varietete jo të përcaktuara;

- b) ndalojnë përkohësisht shitjen e verës dhe prodhimeve tjera deri sa të merret vlerësimi, nëse ka dyshime se vera apo prodhimet tjera nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara;
- c) ndalojnë shitjen e verës dhe prodhimeve tjera të cilat nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë ligj, dhe aktet nënligjore të nxjerrura sipas tij apo sipas marrëveshjeve ndërkombëtare;
- d) konfiskojnë verën apo prodhimet tjera të prishura, të falsifikuara apo me të meta dhe urdhërojnë shkatërrimin e tyre;
- e) urdhërojnë riklasifikimin e verës në kategori me cilësi më të ultë, nëse vera nuk përmbush kriteret e përcaktuara nga ky ligj apo nëse vera është përzier në bodrume të verës në kundërshtim me dispozitat për mbrojtjen e prejardhjes gjeografike;
- f) ndalojnë shitjen e verës e cila është plasuar në treg e shoqëruar me dokumente të cilat nuk korrespondojnë me karakteristikat aktuale të verës;
- g) ndalojnë shitjen e verës dhe prodhimeve tjera të etiketuara në mënyrë të paautorizuar;
- h) caktojnë afat kohor për ri-themelimin e statusit legal të verës dhe prodhimeve tjera;
- i) ndalojnë vazhdimin e aktivitetit të mëtutjeshëm, nëse hapësirat punuese ose pajisjet e prodhuesit, përpunuesit të rrushit dhe verës nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara dhe nëse tregtari, ambalazhuesi ose ruajtësi nuk punojnë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore;
- j) ndalojnë importin dhe eksportin e verës ose prodhimeve që nuk janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore të nxjerrura sipas tij;
- k) propozojnë fillimin e procedurës kundërvajtëse për shkelje të ligjit;
- l) merr mostra në rast të dyshimit se vera, mushti apo prodhimet tjera nuk përmbushin kriteret sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerrura sipas tij, të cilat i dërgon për analiza në institucionin e autorizuar.

46.3. Prodhuesit, përpunuesit, mbushësit paketuesit, tregtarët dhe hotelierët, sa i përket dispozitave të këtij ligji janë të obliguar të lehtësojnë punën e inspektorit dhe ti sigurojnë të gjitha të dhënat dhe informatat e nevojshme sa i përket punës së tyre.

#### Analizat e mostrave Neni 47

47.1. Pronari i produkteve përkatësisht pajisjeve nga të cilët janë marrë mostrat duhet të siguron ambalazhin dhe të paguan çmimin e analizës nëse vërehet se prodhimet apo pajisjet nga të cilat janë marrë mostrat nuk përmbushin kriteret e përcaktuara.

47.2. Nëse rezultatet e analizës tregojnë se mostrat përmbushin kriteret e përcaktuara shpenzimet e analizave i paguan organi, inspektori i të cilit ka dërguar mostrat për analizë dhe vlerësim.

## KAPITULLI X DISPOZITAT NDËSHKUESE

### Ndëshkimet Neni 48

48.1. Personat fizikë dhe juridik do të dënohen për kundërvajtje me dënim me gjobë në shumë prej 500 deri 30.000 Euro për shkeljen e dispozitave të këtij ligji ose akteve nënligjore të nxjerrura sipas tij për:

- a) prodhimin e rrushit ose verës, përpunimin e verës dhe prodhimeve tjera, ruajtjen apo mbushjen nga personat që nuk janë të regjistruar ose nuk ofrojnë të dhëna për regjistrim në mënyrë të përcaktuar dhe brenda afatit kohor të caktuar;
- b) prodhimin e verës ose prodhimeve tjera nëse nuk janë përmbushur të gjitha kushtet e përcaktuara;
- c) shitjen e verës të prodhuar nga rrushi i cili në kohën e vjeljes nuk ka arritur sasinë e kërkuar të sheqerit;
- d) përpunimin e rrushit me teknologji joadekuate;
- e) prodhimi i verës nga rrushi, lëngu apo mushti i importuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
- f) prodhimi i rrushit, verës apo prodhimeve tjera duke përdorur metoda apo substanca enologjike ilegale;
- g) përzjerja e rrushit, lëngut, mushtit ose verës në mënyrë ilegale;
- h) kultivimi i vreshtave të cilat nuk janë klasifikuar në zonën e posaçme për vreshtari;
- i) marketingu ose shitja e verës me cilësi të pavlerësuar;
- j) etiketimi apo shitja e verës ose prodhimeve tjera në kundërshtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore;
- k) marketingu apo shitja e verës dhe prodhimeve tjera të ndaluara të tregtohen;
- l) mos magazinimin e verës së prishur në kontejner të ndarë, të shënuar në mënyrë që të dallohet ose mos raportimi inspektorit përkatës;
- m) shitjen, transportimin ose magazinimin i verës në mënyrë e cila nuk ruan karakteristikat fiziko-kimike dhe organoleptike të verës;
- n) transportimi i më shumë se 20 litrave verë ilegalisht të mbushur dhe etiketuar ose të pashoqëruar nga dokumentet e përcaktuara;
- o) dërgimi apo pranimi i verës pa dokumente të kërkuara;
- p) mos mbajtjen e të dhënave të përcaktuara të bodrumeve të verës;
- q) marketingun apo shitja e verës para afatit kohor të përcaktuar;
- r) shitjen e verës së importuar e cila nuk është vlerësuar ashtu siç është kërkuar nga ky ligj dhe akteve nënligjore të nxjerrura sipas tij;

- s) mos respektimin e urdhrave dhe vendimeve të inspektorit; dhe
- t) pengimin e inspektorit në marrjen e mostrave dhe kryerjen e kontrollit.

48.2. Personi përgjegjës i personit juridik do të gjobitët prej 500 deri 2.000 Euro për kundërvajtjet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

#### Neni 49

Mjetet financiare nga dënimet me gjoba derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

### KAPITULLI XI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

#### Dispozitat kalimtare Neni 50

50.1. Prodhuesit e rrushit, verës apo prodhimeve tjera duhet të regjistrohen jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

50.2. Regjistri i vreshtave ekzistuese dhe vreshtave të mundshme duhet të kryhet jo më vonë se 1 vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

50.3. Vera e prodhuar nga rrushi i rritur në vreshtat të cilat kanë ekzistuar në kohën kur ky ligj hyn në fuqi në pozicionet e paklasifikuara të vreshtarisë ose njërive të posaçme vreshtare, mund të shitet deri në përfundim të pjellorisë së vreshtave, por jo më shumë se 5 vite pasi ky ligj të hyj në fuqi dhe vera e tillë pavarësisht nga cilësia dedikohet vetëm si verë pa karakteristika gjeografike dhe pas skadimit të afatit kohor, do të ndalohej tregtimi i verës së tillë.

#### Neni 51

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji do të shfuqizohen dispozitat e ligjeve të cilat janë në kundërshtim me këtë.

#### Hyrja në fuqi Neni 52

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

**Ligji Nr. 02/L-8  
23 shkurt 2005**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës,**  

---

**akademik Nexhat Daci**